

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **00220-24-1597-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Ardi SH.P.K.
NUI	810517089
Adresa	187,Nënë Tereza,Fushë Kosovë
Vendi	Fushë Kosovë
Kodi postar	12000
Numri Telefonit	049888866
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Milaim Demiri
Adresa elektronike	ardishpk@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.05.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot-1[]Lot-2[]Lot-3

- **Me datën 27.02.2024 AK SHSKUK ka publikuar Njoftimin për Kontratë.**
- **Me date 22.04.2024 AK SHSKUK ka publikuar Njoftim për permisim të gabimit B54**
- **Me date 23.04.2024 AK SHSKUK ka publikuar Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Neni 1,6, 7, 11, 61, 72 i LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1,6, 7, 11, 61, 72 i LPP-se.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 27.02.2024 AK SHSKUK ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material medicinal nga LE për nevojat e SHSKUK-së” me numër të prokurimit 00220-24-1597-1-1-1 dhe 220-24-026-111.

Kundër këtij njoftimi për kontratë OE Ardi shpk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK SHSKUK, për të cilën kjo e fundit ka marrë vendim me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, OE Ardi shpk ka parashtruar ankesë në OSHP. Kjo e fundit më datë 28.04.2024 ka marrë vendim me numër OSHP: 2024/0204 me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE Ardi shpk dhe ka obliguar AK SHSKUK të ndryshoj kërkesat e dosjes së tenderit konform udhëzimeve të OSHP dhe ekspertit shqyrtues.

PROVE: Vendimi i OSHP me numër OSHP: 2024/0204 i datës 18.04.2024.

Më datë 22.04.2024 AK SHSKUK ka publikuar Njoftimin për Informata Shtesë dhe Përmisim të Gabimeve B54.

Kundër këtij njoftimi për përmisim të gabimeve B54 të datës 22.04.2024 dhe Njoftimit për kontratë të datës 27.02.2024 dhe datës 22.04.2024 OE Ardi shpk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK SHSKUK.

AK SHSKUK më datë 23.04.2024 ka refuzuar si të pa lejuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është parashtruar pas afatit ligjor.

PROVË: Vendimi i AK SHSKUK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i datës 23.04.2024.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

///

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*